



**RAPORT TEKNIK PER AKTIVITETIN**  
**SHFRYTËZIMI I GURIT GËLQEROR PLLAKOR**  
**ZONA MINERARE 953/1, OBJEKTI**  
**“JORGUCAT”, Gjirokastrë**

(sipas Ligjit Nr. 10 440 dt. 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Përfshihet në shtojcën 1 kodit 19)



INVESTITOR: “PETRAX” SHPK  
PROJEKTOI: H&M MINING

Ekspert Mjedisit Ing. Miniere Adhurim Caushi  
Ing. Gjeolog Thanas Llahana  
Ing. Markshajdr Lavdrim Saraci



Tiranë 2020

**H&M MINING**  
**PROJEKTE E KONSULENCE**  
**BLOKU “Vasil Shanto”**  
**Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2**  
**Email: dhuro\_caushi@yahoo.com**

# **PERMBAJTJA E RAPORTIT**

## **HYRJE**

- 1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR**
- 2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT**
- 3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVAVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT**
- 4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR**
- 5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN**
- 6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT**
- 7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT**
- 8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR**
- 9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT**
- 10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT**

## **HYRJE**

Sipas ligjit nr.10304, date 15.07.2010 “Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise, subjekti eshte duke pergatitur dokumentacioni e plote per tu pajisur me leje minerare shfrytezimi.

## **HYRJE**

Subjekti “ **PETRAX** ” shpk është një shoqëri vendase REGJISTRUAR PRANE Qerndres Kombetare te Biznesit me NIPT; K12511610N dhe administrator Z. Jani LLESHI.

Sic u sqaruar dhe në kërkesën që I bashkangjitet Raportit Teknik dhe informacionit, subjekti “PETRAX” kryen aktivitetet minerar duke shfrytëzuar gur gëlqeror pllakor në objektin e gëlqerorëve Jorgucat për një periudhë prej 12 vjetësh, që nga viti 2006 kur është pajisur me Lejen e Shfrytëzimit Nr. 953 datë 18.07.2006.

Këtë leje shfrytëzimi sipas ligjit 10 304 dt. 15.03.2010 “për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” e ka rinovuar për 10 vjet dhe është pajisur me Lejen e Shfrytëzimit Nr.953/1 dt. 21.06.2016.

Gjithashtu subjekti është pajisur me Lejen Mjedisore me Nr. 11 Prot, Vendimin nr. 2 I Komisionit datë 20.01.2006.

Subjekti për mungesë të njohurisë në legjislacion dhe për neglizhencë subjektive të organeve Kompetente nuk ka riformatuar Lejen Mjedisore dhe në këto kushte kërkon të pajiset me Leje Mjedisore të re.

Subjekti gjatë 12 vjetëve të aktivitetit minerar nuk ka patur asnjë masë administrative si nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ashtu edhe nga Agjencia Kombëtare e Burimeve natyrore.

Subjekti duke filluar nga viti 2011 e në vazhdim ka paguar garanci rehabilitimi 75380 leke në vit.

Gjatë periudhes 2006-2018 në karrierën “Jorgucat” janë shfrytëzuar 8350m<sup>3</sup> gur gëlqerorë pllakor.

Si nje nga kerkesat kryesore te legjislacionit Shqiptar eshte pajisja me leje mjedisi per objektin per te cilin subjekti ka Leje Minerare Shfrytezimi. Lidhur me kete rendesi te vecant ka edhe “Permbledhja jo teknike e Raportit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin “Shfrytezim I mineralit te gurit gelqeror i mermerizuar , me karriere ne zonen minerale me leje shfrytezimi Nr. 953/1 dt. 21.06.2016. Shoqëria “PetraX” shpk ka filluar procedurat për tu pajisur me leje Mjedisit, pasi aplikoi sipas ligjit për V.N.M paraprake në MTM, dhe përgjigjes dhënë nga A.K.M. me Vendimin për VNM të thelluar Nr. 3850 Prot. dt. 02.08.2019, ku në vazhdim u vazhduan procedura në bazë të Vendimit Nr. 4893 Prot, dt. 10.10.2019, ku njoftohet subjekti “Njoftim për vazhdim procedure për V.N.M të thelluar subjekti “PETRAX” SHPK”.

Ne keto kushte, zhvilluesi i projektit pergatit dokumentacionin e kerkuar, pjese e te cilit eshte edhe “permbledhje joteknike e Raportit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin e shfrytezimit me karriere te zones minerare, me Leje Shfrytëzimi nr. 953/1, rrethi Gjirokastër.

Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, cdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedis eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre . Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor. Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Ndotja
- shterimi i burimeve

Per te shmangur keto probleme shoqerite duhet te mesojm se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat çojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta ( te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

Shfrytezimi i lendes se pare per materiale ndertimi kane çuar ne disa raste prishjen e disa ekuilibrave natyrore per shkak te nje shfrytezimi pa kriter , pa rregulla sipas nje ligjshmerie te caktuar shkencore.

Keto fenomene jane vene re ne shfrytezimin e mineraleve ne afersi te qendrave te banuara lumenjve, zonave turistike, zona me status te vecant mbrojtes etj.

Theksojmë se në Shqipëri vendburime për prodhimin e lendeve të para për industrinë e ndërtimit si gur gëlqeror, zhurë, bazaltë, argjila, gabro, etj që nuk prishin këtë ekuilibër ndodhen në gjithë territorin e vendit.

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar në përdorimin e tokës, efektet lidhur me ndikimet në floren, faunën, burimet e ujit, emetimin e gazeve të sere në atmosferë, shkarkimet në tokë, ujë, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit mineralar të prodhimit të mineralit ndërtues gurit gëlqeror me karrierë mbi mjedisin human.
- Analizën e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për
- Reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.
- Projekti tenton përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuesë të territorit, gjatë shfrytëzimit të tij si qendër rekreative e social-kulturore.
- Për këtë problem u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vërtetime të ndryshme, si dhe të biodiversitetit.

## **1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR**

### ***a) Përkrahja e qëllimit dhe objektivave të VNM***

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një proces që siguron që ndikime mjedisore të rëndësishme, sinjifikante janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë të kënqshme në planifikim, projektim, zbatim të aktivitetit që do të zhvillohet.

*Ndikimi* – efekti i një projekti që ka në mjedisin rrethues

*Vlerësimi* – analiza që i bëhet projektit

*Mjedisi* – elementet abiotike ( kushtet fiziko- kimike të mjedisit) të kombinuara me elementet biotike ( qeniet e gjalle të mjedisit).

### **Qëllimi i VNM- se**

Qëllimi i hartimit të raportit të VNM-se është përcaktimi i efekteve negative dhe pozitive të aktivitetit dhe masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis si rezultat i zhvillimit të projektit shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror të mermerizuar në zonën minerare ***me leje shfrytëzimi nr. 953/1 Jorgucat, rrethi Gjirokastër.***

VNM nuk do të mbulojë çdo aspekt të një efekti mjedisor të projektit, me të njëjtin nivel detajesh, theksi do të vihet në efektet kryesore që shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

### **Objektivat e VNM**

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit, rehabilitimin e hapësirës se shfrytëzuar per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

### ***b) Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin***

- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.*
- *Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014“Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”*
- *Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.*
- *Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhëzim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”*
- *VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”.*

- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 *“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”*. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 *“Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”*. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 *“Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 *“Për zonat e mbrojtura”*. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 *“Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 *« Per largimin publik te mbeturinave »*

## 2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

### a. Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar eshte shfrytezimi i gurit gelqeror me kariere (me punime siperfaqesore ) per prodhimin e gurëve gëlqerorë pllakor me trashësi të ndryshme që ose përdoren direkt në ndërtim ose përpunohen (gdhenden, priten , etj).

Prodhimi i gurrit gëlqeror me kosto të ulët është në gjendje që të përkrah zhvillimin ekonomik te shoqërisë dhe te përmirësojë gjendjen ekzistuese te lendeve te para si dhe Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin hapje, pergatitje dhe shfrytezim te gurit gelqeror, mineral i grupit ndertimore ne objektin Jorgucat, Gjirokastër, Qarku Gjirokastër. Per rreth kesaj zone nuk ushtrojne aktivitet subjekte të tjera. Kjo zone eshte e preferuar per shfrytezimin e gurit gelqeror me kariere siperfaqesore sepse eshte larg qendrave te banuara, nuk ka bimesi te larte, ka te ngritur infrastrukturen rrugore duke patur lehtesira ne transport me kosto te ulet.

### b. Planimetria e vendodhjes se projektit , harta topografike siperfaqja e tokes se kerkuar, kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar, te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

Siperfaqja e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 953/1 është 0.0298 km<sup>2</sup> ose 2.98 ha, deh bëhet shfrytezim gurit gelqeror me kariere ne objektin Jorgucat, Qarku Gjirokastër.

### Vendndodhja e objektit

Zona e kerkuar per shfrytezim ndodhet ne plashetin J-34-005-3-a (Jorgucat) ne shkalle 1:25000 dhe kufizohet nga koordinatat e me poshteme

Koordinata e pikave kufizuese të zonës

Nr i pikes	Koordinatat zones	
	Y	X
1	44 21 885	44 37 475
2	44 21 950	44 37 600
3	44 21 750	44 37 700
4	44 21 700	44 37 575
	S= 0.298 km <sup>2</sup>	

Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytezim është 0.0298 km<sup>2</sup> Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytëzim është pronësi e shtetit .






*Pamje nga afer e zones se projektit Jorgucat*

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E LEJES MINERARE TE SHFRYTEZIMIT  
 Nr. 953, DATE 18.07.2006, OBJEKTI: "JERGUCAT", GJIROKASTER

SHKALLA 1:25 000



**c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti**

Objekti per te cilin hartohet studimi ndodhet ne territorin e Njesise Administrative Jorgucat , Bashkia Dropull. Administrativisht i perket ndarjes administrative te qarkut Gjirokastrë. Zona minerare vendburimi i gurit gelqeror pllakor, ndodhet ne krahun Perendimor te rruges nacionale Gjirokastrë – Kakavije. Ai shtrihet ne shpatin e Malit të Gjerë me lartesi maksimale mbi nivelin e detit.

Qendrat e banuar me te aferta nga objekti jane fshati Jorgucat dhe Zervat.

Objekti lidhet me rruge automobilistike me fshatin Jorgucat, e cila eshte e pasfaltuar dhe ne gjendje jo shume te mire

Gjirokastra është qytet në Shqipërin e jugut me rreth 30 000 banorë. Pergjithesisht eshte qytet muze dhe ndërtimet në zonën muzeale janë me gur gëlqeror. Në qytet ka marrë hov zhvillimi i turizmit si dhe industria përpunuese.

Ne pergjithesi ne rrethin e Gjirokastrës vitet e fundit ka marre zhvillim edhe industria e prodhimit dhe perpunimit te gureve gelqeror, ku aktualisht operojne 4 subjekte. Nga guret dhe pllakat e prodhuara nga subjektet e rrethit të Gjirokastrës realizohen ndërtimet në qytet si dhe ekportohen në Greqi dhe Itali.

## **Fshati Jorgucat**

Fshati Jorgucat është një nga fshatrat e mëdha të Bashkisë Dropull, ku banojnë aktualisht 150 banorë, kryesisht të moshuar, moshë e re punon në emigracion. Me ndarjen e re administrative në këtë fshat është vendosur dhe Qendra e Bashkisë Dropull. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blektori. Në fshat ka dhe aktivitete të tjera si përpunimi i gurit, prodhimi i mobiljeve, lokale shërbimi, etj.

### **ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit**

Projekti nuk kërkon ndërtim të strukturave me themele, ndaj dhe nuk do të trajtojme.

Objekte në shërbim të aktivitetit janë:

Objektet e shërbimit si zyrat, të shërbimit të punonjësve si garderobe, dhoma të ndihmes së shpejte,

### **d. Përshkrim i procesit ndërtimor dhe teknologjik, përfshirë kapacitetet prodhuese/ përpunuese, sasitë e lendeve të para dhe produktet përfundimtare të projektit**

#### **Përshkrimi i sistemit të shfrytëzimit që do të aplikohet.**

Zona ndërtohet nga gelqerore shtrese holle me trashësi 0.02 – 0.14 m. Gelqeroret në teresi kanë ngjyrë gri, gri të çelet deri të bardhe, here - here me pamje sheqerore, në pjesët pranë sipërfaqesore të kuqërremta e të verdha për shkak të ndotjes nga oksidet e ndryshme që ata përmbajnë si perzjerje mekanike.

Në teresi gelqeroret janë të prekur nga një sistem çarjesh përsore e dytesore paralele të terthor shtrirjes së tyre. Sipas trashësisë çarjet kanë rënie afro vertikale me  $85 - 90^{\circ}$ . Në gjykimin tonë ky sistem çarjesh ka bërë që shtresat gelqerore të ndahen në blloqe me permasa të ndryshme.

Për kushtet konkrete të vendburimit të mineralit të gurit gelqeror u projektua sistemi i shfrytëzimit me kariere, me lartësi shkalle 10m, shesh pushimi në mbyllje të aktivitetit 4m dhe vendosje të mjeteve të ngarkimit dhe transportit në sheshin e poshtëm të shkallës.

Ngarkimi i gurit gelqeror dhe transporti deri në destinacion do të bëhet direkt nga fronti i punës. Nisur nga fakti se prodhimi nga karriera është në trajtë blloqesh me dimensione relativisht të mëdha, transporti i tyre deri në portin e Durrësit apo gjatë do të realizohet me mjete të kompanisë “Shega Trans” me të cilën parimisht është rënë dakort. Ngarkimi do të bëhet me eskavatore, dhe makineri me kapacitet transportues 10 m<sup>3</sup>.

Me qenëse disponohen të dhëna të mjaftueshme lidhur me sistemin e çarjeve të shkëmbenjve monolite, duke gjykuar nga sistemi i çarjeve në sipërfaqe, i cili pritet që në këtë lloj shkëmbi të jetë me pak i zhvilluar në thellësi, në projekt parashikohet shkeputja e shtresave të gelqerorëve të bëhet me menytrat e mëposhtme:

1. Në fazën fillestare të prerjes, zona e fillimit të shkallës pas heqjes së shtresës së shkëmbenjve me çarje, e cila konsiderohet si fazë kalimtare, parashikohet të bëhet shkeputja e tyre:

- Ne rastin e prezences se çarjeve te dukshme me eskavator duke perdorur koven ose çekiçin e tij;
- 2. Ne fazen e kapercimit te zones kalimtare dhe futjes ne zonen e shkembenjve monolite parashikohet te behet shkeputja e blloqeve :
  - Në rastin e shtresave me trashësi më të vogla se 6 cm, shkëputja e tyre do të bëhet me mjete të thjeshta, lloz metalik, kazma, vare, etj që këto të mos thërmohen nga cekici.

### **Percaktimi kapacitetit prodhues**

Prodhimi i mineralit te gurit gelqeror me kariere u projektua duke patur ne konsiderat keto kerkesa:

- 1-Sasin e pergjithshme te rezervave te vendburimit te mundshme per shfrytezim.
- 2- Kushtet tekniko-minerare te vendburimit .
- 3- Kerkesat e investitorit per mineral gur gelqeror.

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit direkt dhe të përpunuar si dhe eksport.

Kapaciteti vjetor i prodhimit është 1000m<sup>3</sup>.

### ***e. infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja***

Infrastruktura rrugore e zones se projektuar eshte pjeserisht e ndertuar. Zona qe kerkohet per tu shfrytezuar eshte ne te djathte te rruges nacionale Gjirokastër – Kakavije, e cila duket qarte edhe ne hartën topografike te shkalles 1 :25 000.

Hapja e vendburimit do te behet nga rruga ekzistuese e fshatit Jorgucat.

### **Furnizimin me uje**

Aktiviteti qe do te kryhet kerkon perdorim uji cili do te sillet deri ne subjekt me bote Uji qe perdoret per lagjen e territorit per shmangien e pluhurave gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqeror sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

**Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik** Persa i perket energjise elektrike per zyren lidhja do te behet nga rrjeti kryesor i zones i cili eshte ne afersi. Rrjeti i energjise elektrike eshte ekzistues sepse furnizon edhe fshatrat ne afersi. Ne baze te kontrates qe do te lidhet me sistemin shperndares te energjise elektrike do te kemi nje nje linje elektrike te tensionit te ulet. Parashikohet qe sasia e harxhuar e energjise nga zyrat si dhe per ndricim te kariereve te jete 25 kë/ore.

### Organizimi i punes dhe fuqia punetore

Ne kushtet gjeografike dhe klimaterike ku ndodhet karriera , shfrytezimi i mineralit se bashku me punimet e tjera pergatitore (transhe ,rruge dhe zbulim) parashikohet te zgjate mbi 25 vjet . Ne te per kushte optimale pune per kapacitet 1000 m<sup>3</sup> deri 2000 m<sup>3</sup> blloqe ne vit parshikohet te punojne:

#### Personeli i punes ne Karriere

Nr	Personel	Punonjes
1	Drejtues teknik ing minere	1
2	Puntoret e linjes se prerjes	3
3	Eskavatorist	1
4	Shofere	1
5	Gur skalitës	3
6	Operator ne ngarkues pirun	1
7	Roje objekti	2
	Shuma	12

Regjimi i punes do te jete me nje nderese ne dite dhe 22 dite ne muaj.

Punonjesit qe do te punesohen do te jene me eksperience ne kryerjen e proceseve te ndryshme te karakterit minerar.



### ***PLANI DHE MASAT PER REHABILITIMIN E MJEDISIT***

Ne mbeshtetje te legjislacionit minerar Shqiptar, sikunder eshte parashikuar edhe ne projektin e shfrytezimit i cili eshte mbrojtur ne Keshillin Teknik te AKBN, eshte vendosur qe per çdo vit subjekti do te paguaj garancine bankare te rehabilitimit dhe ne vartesi te kushteve ose do ta rehabilitoje vet zonen e shfrytezuar ose do nje subjekti te specializuar sipas procedurave te vendosura nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

Punimet e rehabilitimit konsistojne ne .:

- Krijimin e siperfaqeve per mbjellje
- Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres.
- Mbjelljen e siperfaqeve te reja me drure si, dushk ,shkoze dhe dellinje dhe barishte te ndryshme.
- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.

### **Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne uljen e ndotjeve gjate punimeve ne karriere te ajerit nga pluhuri, gazet mbrojtja nga zhurma,si dhe uljen e efekteve negative hapsinore dhe ne territor, ne faunen dhe floren. Pikesynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

### **Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene :**

- Mbjellje me filiza ,si dushku, shkoze dhe dellinje gjithe periferise ne shkallet e karrieres ne menyre progresive dhe ne fund te shfrytezimit edhe ne sheshin e depozitimit provozor te sterileve Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e shkalleve te karrieres
- Pemiresimin e bimesise ne te gjitha periferine e karrieres me bimesi te zones si dushk dhe dellinje, per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi prej atyre te paprekura nga projekti duke lene mundesine per perhapje te metejshme teketyre specieve vendase ne territoret fqinje.Te dy keto masa mund tesherbejne si bariera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit.
- Uljen e prodhimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur pluhurat. Nga ana tjetere per te ulur efektet negative, gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e shesheve te punes dhe sidomos,lagia e materialit te nxjere. Kjo do te mbroje ambientin nga pluhuri gjate transportit te prodhimit

### **Rehabilitimi i territorit**

Masat rehabilituese do tekonsistojne ne :

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezoget.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 10 m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe

evitimin e pamjeve te pakendeshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesis se pergjithshme te tarraces rreth 10 m.

Rradha e mbjelljeve do te jete nga lart-poshte, duke lejuar mundesine per vetepershapjen e specieve mbi bazat eaktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 4m. Kjo lloj mbjellje lejon vetepershapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

### **Rehabilitimi i plote i mjediseve te territorit do te jete si me poshte:**


#### **Mbjellja e taracave**

- Mbjellje e fushes se shfrytezuar
- Mbjellje e shesheve ne shkallet e karieres
- Filiza 2 vjecare ne periferi
- Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi i perteritjes se shkurreve.


Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparsi do te marre rritja e abudances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekohesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si qelbesit dhe buklit (nuses se lales )






**PROFILI I-1**  
**ME SHKALLET E KARRIERES TE REHABILITUARA PAS SHFRYTEZIMIT**  
 SHKALLA 1 : 1.000



**PROFILI II-1**  
**ME SHKALLET E KARRIERES TE REHABILITUARA PAS SHFRYTEZIMIT**  
 SHKALLA 1 : 1.000




**SHPJEGUESI**

-  Gjelqerora te Eocenit
-  Toka Vegetjale
-  Fildane Pjlore



LEDA MINERARE E SHFRYTEZIMIT N° 953 OBJEKTI I GELQEROREVE "JERKOCAT" GJURKOKASTER, Shtet: "PETRAK" Sh.p.k. PËRGATITË: Geon NB Consulting Sh.p.k. Ing. Gjeologj B. AGO	SHKALLA 1 : 1000	GRAFIKU N°: 12	VITI 2016
---	---------------------	-------------------	--------------



**Kanalet dhe kunetat.** Kunetat dhe kanalet do të bëjnë që rrjedhja e ujrave sipërfaqore të behet me forcë më të madhe, duke përfunduar në këto mënyra grumbullimin e tyre dhe me pas depozitimin gradual në toke. Në perimetrin e shkalleve të karrieres si dhe në vet shkallet do të hapen kanale për grumbullimin e ujit, veçanërisht ujit të shirave për tu drenazhuar në proosken pranë

Kombinimi i punimeve të shfrytëzimit të karrieres me ato të zbutjes së impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do të ketë si pasojë edhe rritjen e numrit të të punësuarve

#### 4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

##### 4.1 Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit

Sipërfaqja në të cilën do të zhvillohet aktiviteti i shfrytëzimit është formacion shkëmbor karbonatik i përfaqësuar nga gelqerore dhe shtresa stralore.

Sipërfaqja e zones minerare për shfrytëzimit, vendoset në masivin karbonatik të malit të Gjerë, në pjesën juglindore të tij, në lartësi nga 400m deri +440 m.

Ne Harten Gjeologjike te Shqiperise shkembijnje karbonatike jane te moshes Eocenit dhe masivi karbonatik i Malit të Gjerë zgjatet per 25 km me drejtim te pergjithshem veri veri – perendim me azimut  $300^0$  dhe renie veri – lindje me azimute qe variojne nga  $20 - 30^0$  deri ne  $50 - 60^0$ .

Ne ekstremin juglindor te tij kuota me e lartë i Malit të Gjerë është +1468m mbi gelqeroret e kretes se siperme ne trajte pulle vendosen (me pushim stratigrafik) gelqeroret e eocenit ( $Pg_2$ ).

Zona ne te cilen ndodhet objekti perfaqson nje pjese te shpatit te malit te Gjerë që ben pjese ne zonen Gjeologo-Tektonike - Jonike .

Zona ne studim ben pjese ne njesine fiziko - gjeografike te krahines Jugore , malore .

Objekti i gelqeroreve per te cilin hartohet studimi dhe kerkoet leja e shfrytezimit ndodhet ne territorin e fshatit Jorgucat te rrethit te Gjirokastrës. Objekti ndodhet ne jug-perendim te fshatit Jorgucat , dhe në shpatin lindor të tij.

Zona minerare ku është dhënë Leja Minerare e shfrytëzimit Nr. 953/1, ndodhet në jug-perëndim të fshatit Jorgucat dhe në veri të fshatit Zervat në jug të qytetit të Gjirokastrës. Largësia nga fshatrat është 1-1.5km. objekti është I padukshëm nga rruga nacionale Gjirokastrë – Kakavije.

Në zonën që do të shfrytëzohet dhe në zonën përreth kësaj nuk ka burime ujore. Fshatrat furnizohen me uje me ujesjellesa qe e marrin ujin me shpime qe jane kryer ne fushen e Drinos.

Shtrirja e kësaj sipërfaqe është nga veriu në jug ndërsa rënia nga perëndimi në lindje.

Shpenzimet e pergjitheshme te rehabilitimit pas shfrytezimit jane:

- Siperfaqe e karrieres qe do te shfrytezohet eshte 2.98 ha dhe shpenzimet e pergjitheshme per kryerjen e rehabilitimit pas shfrytezimit jane 2.98 ha x 322750 leke/ha dhe shpenzimet per rehabilitimin e saj rezultojne 961795 leke.
- Shuma e pergjitheshme per mbylljn edhe rehabilitimin e karrieres do te jete 1232905 leke
- Garancia vjetore per rehabilitimin per 10 vite do te jete 123290 leke/vit

### *- Pershkrim i faktoreve klimatike*

#### **Klima**

Leja minerare e shfrytezimit të objektit Jorgucat perfshihet ne Zonen Lindore te zones klimatike mesdhetare te Shqiperise. Rajoni rreth saj ndikohet nga klima kontinentale me dimer relativisht te ashper e te ftohte dhe vere te fresket e te ngrohte.

Dimri qe pergjithesisht eshte i ashper e me lageshti shoqerohet rralle dhe me rreshje bore. Ndersa vera eshte e ngrohte me pak lageshti. Ne zone ka mbi 1650 ore ndriçim dielli, muaji korrik me 2855 ore e muaji dhjetor 75 ore.

Temperaturat në zonë luhaten nga -2 deri në 10 grade në dimër dhe 30-35 gradë Celsius në verë pa përjashtuar raste të veçanta të luhatjes së temperaturave. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 12.6 grade Celsius, ne korrik e gusht temperatura shkon nga 26 - 35 grade Celsius, ndersa ne janar zbret ne 6 grade Celsius, here here nen zero.

Vlera mesatare e rreshjeve arrin ne 2215 mm/vit, dhe ne periudhen tetor - maj bien 75% e tyre.

Sasia e regjistruar e reshjeve maksimale eshte 168 mm shi ne 24 ore (viti 2008).

Lageshtia e ajrit sipas stineve rezulton nga 68 % - 74 %. Drejtimi i erërave eshte kryesisht Veri Perendim – Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla terthor me te

Drejtimi i erërave eshte kryesisht Veri Perendim –Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla oblik me te

Ushtrimi i aktiviteti te shfrytezimit dhe perpunimit te gurit gelqeror, duke mare ne konsiderate masat e parashikuara ne projekt, nuk do te ndikojne ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do t'a ndote ate. Parashikimi ne projekt i masave shtese gjate proceseve teknologjike te shfrytezimit si perdorimi i uje gjate kryerjes se proceseve teknologjike ne karriere dhe atyre te perpunimit te metejsheem te gurit gelqeror sistematike si dhe sperkatja e stoqeve te gelqerorit dhe rrugeve te transportit do te parandalojne ngritjen e pluhurit dhe ndotjen e ajrit.

Zona ku do të kryhet shfrytëzimi bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare kontinentale e izoluar plotësisht nga rrymat e ngrohta që vijnë nga mesdheu dhe adriatiku. Zona kryesisht është me verë të nxehtë e të thatë, reflektimi i rrezeve të diellit nga gëlqerorët e bën të nxehtë këtë zonë ndërsa në dimër zona është me rreshje shiu e dëborë dhe nën efektin e acartë të malit të Tomorrit që ndodhet në veri të zonës.

Temperaturat në zonë luhaten nga -3 deri në 5 grade në dimër dhe 30-35 gradë në verë pa përjashtuar raste të veçanta të luhatjes së temperaturave.

#### ***- Pershkrim i sizmicitetit i zones se projektit***

Studimet sizmoteknike kane te bejne me te dhenat per termetet , ato lidhin sizmicitetin me shkeputjet aktive. Kushtet e vendosjes strukturore dhe tektonike te ndodhjes se termeteve jane perftuar kryesisht nga analiza pergjithesuese e te dhenave nga gjeologjia, gjeofizika dhe dukurite sizmologjike. Dihet se aktiviteti i sotem termetor lidhet ngusht me strukturen e sotme gjeologjike, me strukturen neotektonike te vendit tone. Eshte tashme e mirenjohur dhe e pranuar nga shumica e studiusve se shkeputjet tektonike jane burimet e çlirimit te energjise sizmike. Termeti ndodh atje dhe atehere ku edhe sforcimet e lindura deformimet tektonike , tejkalojne kufirin e fortesise se lendes pergjate ketyre shkeputjeve.

#### **Tektonika.**

Rajoni i objektit eshte prekur me vone nga tektogjeneza e oligocenit te mesem dhe zhvillimit te metejsheem te karakterit gjeollogjik

Ai kufizohet nga dy tektonika te shkalles se pare me shtrirje Veri Lindje Juge Perendim. Linja tektonike janë larg zonës që do të shfrytëzohet dhe kanë ndikim minimal.

Me pas ai eshte prekur nga tektonika dytesore me drejtim gati kryq me ato te mesipermet, te cilat prekin dhe vete objektin .

Tektonikat dytesore kane shtrirje Veri Lindje Juge Perendim me renie Jugelindore me kend renie  $70^{\circ}$  - $75^{\circ}$ .

Prania e tyre nuk veshtireson kushtet e shfrytezimit te objektit .

Parametri tjetër i rendesishem i studjuar dhe vrojtuar ne teren ne pjesen e sipërme te majes dhe ne shpatin e zhveshur te objektit eshte dhe sistemi i çarjeve natyrale te shkembenjve gelqerore te objektit .

Sistemi i çarjeve natyrale te shkembenjve eshte gati ortogonal me çarje paresore me azimut shtrirjeje  $250^{\circ}$  - $270^{\circ}$  azimut renie  $340^{\circ}$  - $360^{\circ}$  dhe kend reie  $72^{\circ}$  - $85^{\circ}$  . Njeri drejtim i planeve te çarjeve orientohet gati kryq me shtrirjen e pergjitheshme te objektit ndersa tjetri sipas shtrirjes gati sipas planit te zhveshjes natyrale te tij ne zonen e profileve .

Distanca midis planeve te sistemit paresor te çarjeve te dokumnetuar ne siperfaqe mbi 1.7-2.5 m, këto çarje nuk prishin cilësinë e shtresave të gëlqerorëve.

Çarjet e tjera dytesore qe takohen ne siperfaqe jane shkaktuar nga erodimi i materialit çimentues se shkembit dhe nuk priten te takohen ne thellesi te tij (mbi 3m).

Vrojtimet e kryera ne pjesen e zhveshur te shpatit tregojne per pranine vetem te sistemit paresor te çarjeve i cili dhe ketu eshte me dendesi me te vogel ( i rendit mbi 2m).

#### ***- Pershkrimi ujerave siperfaqesore dhe nentokesore ne zonen e projektit***

##### **Ujrat siperfaqesore.**

Me termin ujra siperfaqesore ne sheshin e zones minerare do te kuptojme reshjet e shiut qe bien mbi siperfaqen e ketij sheshi gjate vitit.

Reshjet sapo bien ne kontakt me siperfaqen e tokes levizin ne dy rruge kryesore, si rrjedhje mbi toke (siperfaqesore) dhe si ujra qe infiltrojne nen siperfaqen e tokes e qe quhen ujra nentokesore.

Raporti ndermjet ketyre dy rrugeve natyrisht varet nga faktore te tille si mbulesa vegjetale, perberja litologjike e pershkueshmeria e shtresave, struktura gjeologjike, morfologjia e relievit etj. Gjithesesi nje gje eshte e sigurte qe rrjedhja mbi siperfaqen e tokes ndodh ne ato raste kur reshjet jane intensive e te zgjatura ( disa ditore) dhe sasia e ujit qe grumbullohet ne siperfaqe eshte me e madhe se ajo qe infiltron poshte siperfaqes.

Sikurse theksuam me larte ne gjysmen jugperendimore te sheshit te zones minerare ku siperfaqia eshte me ulje ngritje te buta me diferenca lartesie 5- 10 – 15 m levizja e ujit te reshjeve si rrjedhje siperfaqesore eshte me e ngadalte se ne gjysmen veri – lindore ku relievi eshte ne trajte shpati te pjerrret me kende renie nga 5 deri ne  $25^{\circ}$  .

*Ne sheshin e zones minerare ujrat e reshjeve levizin ne trajte te rrjedhjeve siperfaqesore sepse rrjeti hidrografik (perroska e perrenj) thuajse mungon.*

## **Ujerrat nentokesore.**

Ujrat nentokesore ne sheshin e zones minerare ushqehen nga reshjet e shiut dhe te debores te cilat filtojnë poshte permes mbuleses vegjetale dhe shkembinjve karbonatik qe ekspozohen ne siperfaqe. Ashtu sikunder ne siperfaqe ujrat levizin ne rreke, perrenj etj. ashtu edhe nen siperfaqe megjithese me ngadale ujrat (tashme nëntokësor) levizin e rjedhin nëpër poret e të çarat e masivit gelqeror, te cilat deri ne 10 - 15 m e para nga siperfaqia jane relativisht te zhvilluara. Thellësia e ujërave nëntokësore është mbi 200m dhe nuk ndikohen nga punimet e shfrytëzimit.

### ***Hidrologjia***

Nisur nga llojshmeria shkembore, per zonen e marrre ne studim kemi te bejme me kompleksin e shkembinjve qe filtojnë ujra ne depozitimet shkembore te objektit e perbejne gurin gelqeror. Burimet qe lidhen me keta lloje shkembinjesh jane me teper burime çarjesh, verehen raste qe takojme burime me debit te paperfilleshem ne periudhen e rreshjeve, ne periudha te thata nuk ka presence ujrash.

### ***4.2 Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit - pershkrim i habitateve kryesore ne zonen e projektit si dhe foto ilustruese***

Në aspektin ekologjik, larmia biologjike, flora dhe fauna në tërësinë e saj ne zonat kodrinore paraqet një pamje të një larmie përfaqësuese, pra të një rajoni gjeografik më të gjërë, mbizoterojnë zonat e zhveshura me bimesi te ulet shkurre dhe dushk etj, ka pak zona me bimesi dhe mungojne pyjet e larta, gjithashtu dhe fauna e zones eshte e varfer.



*Pamje nga zona minerare , ku duket qarte vegjetacioni i paket pasi gelqeroret dalin direkt ne siperfaqe dhe mbulesa mbi keta gelqerore eshte e vogel*

### ***Peizazhi dhe topografi***

Siperfaqja ne te cilen do te shtrihet shfrytëzimi, nuk duket nga banoret e fshatrave apo qendrave te banuara perreth me perjashtim te rasteve per kalimtarete qe udhetojne ne rrugen prane pasi ato jane larg.

Duhet theksuar se siperfaqia qe do te shfrytëzohet eshte nje shpat mali.

Profili gjeologjik topografik i zones pergjithesisht eshte gjatesor gati vije drejte me valezime te lehta te sharnierit dhe i pa trazuar.

***Pershkrim i vegjetacionit ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetarte tyre.***

### ***Bimesia***

Bimesia ne kete zone eshte shkurre e shperndare, jo uniforme e cila varet nga kushtet klimaterike dhe perberja e shkembinjve. Pergjithsisht zona e kerkuar per shfrytezim eshte i çveshur pasi gelqeroret dalin direkt ne siperfaqe dhe mbulesa e tyre eshte shume e vogel dhe bimesia eshte e paket dhe rralle e perfaqesuar nga dushku ,shkoze, ku lartesia e tyre nuk i kalon mbi 0.5-1.5 meter. Rrjedhimisht shfrytezimi nuk prek drure te mbrojtur, frutore te cila mungojn ne zone

***-Pershkrimi faunes ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre***

**Larmia faunistike** Vleresimi mbeshtetet kryesisht ne studimet e kryera nga te huajt dhe Shkencetaret Shqiptare me karakter taksonomik ne fushen e entomologjise, te cilat trajtojne perberjen llojore te insekteve te rendeve: Coleoptera, Lepidoptera, Hymenoptera, Hemiptera, etj., si dhe studime te vecanta me karakter biologjik per isekte demtuese, si tenja e rrushit (polyc botrana Schiff), krimbi misrit (Pyrausta nubilalis), miza e ullirit (Dacus olean). Studime jane kryer gjithashtu edhe per grupe te tjera shtazore: butaket, ekinodermat, reptilet, gjitaret, etj.

***- Pershkrim i zonave te mbrojtura prane vendit ku propozohet te zbatohet projekti perfshi edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj.***

Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse ne objektin e projektuar dhe per rreth nuk ka zona te mbrojtura me status te vecante. Eshte per t'u theksuar se nuk ka asnje veper arti te ndertuar nga njeriu.

## **4.3 Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese**

***- cilesia e ujerave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se***

Kushtet hidrogjeologjike te vendburimit

Duke qene se vendburimi ndertohet teresisht nga shkembinj gelqerore edhe ujrat nentoksore i perkasin ketyre shkembinjve. Guri gelqeror qe shfaqet ne siperfaqe, ndertojne strukturen e vendburimit me zgjatje veriperendim – juglindje, dhe renie verilindore. Gur gelqeror e vendburimit jane pllakore dhe me çarje, pervec planeve te shtresezimit. Per nga ujembajtja e tyre guri gelqeror ne teresi karakterizohen nga nje filtrim i dobishem i larte i reshjeve atmosferike, dhe pershkueshmeri te larte, natyrisht ne vartesi te shkalles se çarshmerise, te shtresezimit, karstezimit dhe nderlikimit tektonik te tyre. Ndersa guri gelqeror e vendburimit karakterizohen nga ujembajtje e paket, çka spjegohet me drenimin e larte te ujrave ne thellesi, kryesisht nepermjet shtresezimit te dukshem dhe çarshmerise se gurit gelqeror.

Ujrat e drenuar dhe ato sipërfaqore shkarkohen në zonën me të ulet në afërsi, i cili është edhe niveli më i poshtëm i shfrytëzimit të gurit gelqeror të vendburimit. Nga sa thame më lartë kushtet hidrogeologjike të vendburimit janë të favorshme, sepse edhe gjatë hapjes së shkallëve të shfrytëzimit, ujrat nëpërmjet shtresëzimit do të drenohen në thellësi, drejt fushës.

***- Cilesia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së***

Përsa i përket cilësisë së ajrit në zonë ai konsiderohet me parametra të pranueshëm duke qenë se ndodhet larg zonave të banuara dhe nuk është i ndotur nga veprimtaritë e industrisë. Edhe zhvillimi i aktivitetit të shfrytëzimit nuk do të shkaktojë ndotje të ajrit sepse nuk do të ketë emetime të gazeve ndotes.

***- Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së***

Në afërsi të projektit nuk ka veprimtari të cilat të shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara.

#### **4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti**

- Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti

Zona ku do të shfrytëzohet guri gelqeror ndodhet në territorin e bashkisë së Dropull në territorin e fshatit Jorgucat në shpatin lindor të malit Leshnje

***- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës***

Popullsia e zonës merret kryesisht me bujqësi, blegtori, objekte industriale, objekte shërbimi dhe një pjesë ndodhet në emigracion. Zonat e banuara janë fshatrat Zervat, Jorgucat, dhe fshati Grapsh. Për një aktivitet minierar me permasha të vogla deri të mesme ekziston fuqi punëtore e kualifikuar nga popullsia rreth e qark, gjë që është avantazh për zhvillimin e veprimtarisë minierare. Vitet e fundit në rrethin e Gjirokastrës është zhvilluar dukshëm aktiviteti i prodhimit të gurit gelqeror i cili shtrihet nga fshati Lazarat deri në fshatin Zervat, ku operojnë katër karriera guri.

***- Përdorimi i tokës në zonën e projektit***

Zhvillimi i projektit të shfrytëzimit nuk do të kërkojë toke shtesë veç asaj të miratuar dhe të shpallur në konkurrencë për shfrytëzimin e gurit gelqeror nga MEI (sot MIE) për të cilën është shpallur fitues shoqëria “PETRAX” shpk.

***- Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit***



Lidhja e objektit me rrugë ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse në objektin e projektuar dhe për rreth nuk ka zona të mbrojtura me status të vecantë.

## **5. Një përshkrim të ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen**

### **5.1 Ndikimet negative në mjedis**

#### ***- Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit***

Sipërfaqja në të cilën do të bëhet shfrytëzimi është larg nga rrugët kryesore të levizjes, larg nga qendrat urbane dhe rurale dhe nuk duket nga qendrat e banuara, me përjashtim të rasteve të kalimtareve që udhetojnë në rrugën pranë.

Duhet theksuar se sipërfaqja që do të shfrytëzohet është kurrizore. Aktiviteti shfrytëzimit me kariere prek përkoheishtë peizazhin ekzistues dhe topografinë e saj për gjatë kryerjes së aktivitetit.

Me masat që do të merren për rehabilitimin e saj, gjelberimin me bimë që rriten në zonë, gjatë shfrytëzimit dhe në mbyllje të aktivitetit, peizazhi dhe topografia e zonës do të përmirësohet dukshëm do të krijohet një ambient panoramik i këndshëm për syrin e njeriut dhe çlodhës.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes së karieses dhe shfrytëzimit të shkallës së parë dhe të dytë është faktor negativ.

Nga dëmtimet e pyjeve është rritur dukshëm erozioni, është ulur ndjeshëm numri i shpendëve dhe folezimi i tyre, janë çrregulluar agroekosistemet, ndjehet mungesa e rolit të tyre pastrues, shëndetësor etj.

Shfrytëzimi gurit gelqerordo të bëhet me kariere nga lartë poshtë me lartësi shkallë shfrytëzimi 10m, dhe gjeresi sheshi shkallë në mbyllje të aktivitetit 4 m që do të pëllëzohet.

#### ***- Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës së projektit***

Zona që do të shfrytëzohet nuk ka bimesi të lartë është e mbuluar me shkurrë dhe në vende të vecanta është çfaqje shkembore. Në këto zone nga vrojtimi që kemi bërë dhe nga fotografit bashkangjitur bimesia që do të shpëllëzohet përbehet nga: shkurrë si shkoze dhe dellinje e rralle, etj..

Nga ky aktivitet nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e përcaktuar në VKM nr. 804. dt. 4.12.2003 dhe e listuar në urdherin e Ministrit nr. 146, dt. 8.5.2007

Nga subjekti në zbatim të projektit do të merren masa që zona në shfrytëzim të jetë gjithmone e kufizuar dhe të rehabilitohet duke u pëllëzuar.

Ndërsa për të menjanuar erozionin nga ujërat e rreshjeve atmosferike në skarpën e sipërme të shkallëve do të ndërtohen kanale dhe kuneta që ujërat të drejtohen në zona që nuk dëmtojnë tokën, gjithashtu sheshet e shkallëve të karieses do të hapen me përresi nga skarpata e shkallës që ujërat të rrjedhin në drejtimin e duhur.

**Zona e kerkuar për shfrytëzim nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimtari si Zonë e Mundëshme" për tu shpallur "Peizazh i mbrojtur".**

***- Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve***

Zhvillimi i aktivitetit do të sjell emetime të pluhurave në mjedis gjatë shfrytëzimit të karrierës, burime të tjera ndotëse për ajrin nuk do të ketë. Pajisjet që do të përdoren për shfrytëzimin dhe transportin e gurit gelqeror do të jenë bashkohore dhe në gjendje të mirë teknike në mënyrë që të shmangin emetimet nga djegia e lendeve djegëse që ato përdorin.

Në vendet e caktuara në projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit të përdorshëm dhe përpunimi i tij me toke vegjetale për të mundësuar mbjelljen e bimëve dhe pemeve karakteristike të zonës gjatë fazës së rehabilitimit. Dherat e depozituara në damba do të përpunohen me dhera të pasuruara me humuse, do të transportohen dhe shpërndahen në sheshet e shkalleve me trashësi mbi 20cm dhe do të pyllëzohen me bimë që rriten në zonë për gjelberimin e saj.

**- Ndikimet negative shtese ( kumulative) në cilësinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyje, burimet ujore.**

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, floren dhe faunën e zonës, burimet ujore.

Shfrytëzimi i gurit gelqeror rreth karriere është një proces i thjeshtë pune prerje me litar të diamantuar të blloqeve, ngarkim të prodhimit me eskavator dhe transport me kamione. Mëqenëse nuk do të përdoren në procesin e shfrytëzimit lende të dëmshme, nuk do të ketë shkarkime të lendeve kimike të dëmshme për mjedisin në ajër, toke dhe ujë.

Sipërfaqja që do të nënshtrohet shfrytëzimit nuk është tokë bujqësore produktive.

Ushtrimi i aktivitetit në këtë sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës bujqësore. Tokat bujqësore ndodhen jashtë zonës ku do të kryhet aktiviteti.

**- Ndikimet sociale të projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit ( si zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj )**

Ky aktivitet do të kryet larg zonave të banuara, në shpatin e malit të Gjerë me depozitime gjeologjike të gurit gelqeror.

Zbatimi i projektit nuk kërkon ndryshime në popullsi, spostime të zonave të banuara ose krijimin e zonave të reja banimi, dhe nuk demton objekte industriale pasi nuk ndodhen brenda sajë etj.

Aktiviteti i shfrytëzimit të vendburimit do të bëhet në një zonë të kufizuar në krahasim me sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit.

Për zhvillimin e aktivitetit nuk do të përdoret tokë shtese vec asaj të miratuar për shfrytëzim.

Nuk do të përdoret lende eksplozive

**- Në varësi të natyrës të projektit një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis**

### ***Rreziqe me pasoja ne mjedis***

1. Dentim habitatesh dhe fole speciesh ne zonen ku do te kryhet shfrytezimi.
2. Renien e ndonje zjarri ne ambjentin e zones se shfrytezimit.

### ***Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik***

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknologjik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes.

Shfrytezimi i burimit natyror per nxjerrjen e gurit gelqerordo te behet sipas projektit dhe ne sasine dhe kohen e parashikuar.

## **5.2 Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis**

*- lloji i ndikimeve te identifikuara ( direkte dhe jodirekte)*

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

***Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.***

	<b>Ndikimi i mundshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrejedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike dhe nderrimit te vajrave ne makinerite e karrieres gjate prodhimit dhe transportit te gurit gelqeror.

***Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.***

	<b>Ndikimi i mundeshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive te karrieres.	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive te karrieres..
3	Emetimi i nxehtesise dhe zhurmes nga shperthimi i lendes plasese.	Nuk do te kete emetim te nxehtesise dhe zhurma mbi normat e lejuara nga perdorimi i lendes plasese.

***Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.***

	<b>Ndikimi i mundeshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Shqetesim i mundeshem i faunes.	ndikim i perkoshem.

*- mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te zbatohen/ ndermerren masa zbutese*

Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:

- Makinerit e gërmimit , te ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Ne karriere nuk do te perdoret lende eksplozive
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat puntoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

Brenda zones karieres vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del se ne distancen 10m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin 70 dB.

Emetimet ne ajer perfaqsohen nga pluhuri qe krijohet gjate gërmimit, ngarkimit, shkarkimit te gurit gelqeror, levizjes se makinerive ne territorin e karieres ndersa ndikimi nga gazet shkaktohet nga mjetet motorrike, eskavatoret, fadromat, kamionet dhe mjetet e tjera motorrike qe levizin ne karriere.

#### ***Me projekt per mbrojtjen nga pluhuri do te merren keto masa.***

Per te eliminuar pluhurin qe krijohet gjate ngarkimit te gurit gelqeror, transportit dhe levizjes se mjeteve ne shkallet e karieres, makinat do te mbulohen me mushama.

#### ***Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa.***

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore. Numeri i mjeteve motorrike ne karriere eshte i kufizuar ne jo me shume se nje eskavator dhe nje fadrome per ngarkimin e gurrëve.

Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike. Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e shfrytezimit, keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karieres, floren dhe faunen per rreth saj. Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e karieres ata do te pajisen me mjete mbrojtese nga pluhuri dhe gazet.

### **6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT ( NESE KA TE TILLA)**

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

### **7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT**

Nga zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit ne zone do te ket impakt pozitiv ne mjedis dhe komunitet.

Per sa i perket ndikimeve pozitive ne mjedisin e zones se karrieres se gurit gelqeror ato jane si me poshte.

- Shfrytezimi i lendes se pare te gurit gelqeror
- Ndertimi i infrastruktures rrugore e cila do te perdoret nga banoret ezones.
- Zona qe ishte e çveshur do te pyllezohet per rreth objektit dhe do te ndikoj ne rregullimin e peizazhit
- Do te punsohen disa punonjes ne objekt do te permisoj kushtet e jeteses se punonjesve te zones
- Do te shtoje prodhimine mineralit te gurit gelqerori cili eshte nje mineral i rendesishem ne industrine e ndertimit ne rang kombetare dhe do te zbusnevojat per kete lende te pare qe jane shume te medhaja.

## **8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV I IDENTIFIKUAR**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Por pikesynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

### ***Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis***

#### ***a.Planifikimi i zones***

Per shmangien dhe parandalimine erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar mbushja , sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i siperfaqeve te shfrytezuar.

Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhe permisimin e pamjes se pergjithshme te zones se shfrytezuar.

Duhet theksuar se siperfaqia e caktuar pe shfrytezim eshte e vogel dhe nuk perben ndonje ndikim ne zone.

#### ***b.Masat teknike***

Per parandalimin e erozionit subjekti parashikon ne nje vit te kryeje punimet e meposhtme

- Dhenia e pjerresise shkalleve te karrieres me pjerresi ne drejtim te zones se shfrytezimit.
- Ndertimin e kunetave ne skarpatat e siperme te shkalleve per disiplinimin e ujrave

- Mbjellje para se te filloje shfrytezimi te te gjitha periferive te tjera me peme karakteristike te zones per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi i pjeseve te paprekura nga projekti, mbjellja do te behet duke marre mendimin e specialisteve te ndermarrjes pyjore . Keto masa do te sherbejne per mbrojtjen nga pluhurin qe mund te nxitet nga aktiviteti gjate shfrytezimit.
- Uljen e intensitetit te shfrytezimit per stinen e veres duke evituar keshtu sa te jete e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjeter per te ulur efektet erodive gjat periudhave te thata do te perdoret lagia e terreneve nen pune dhe lagia e vendgumbullimit te materialit te nxjerre. Kjo do te evitoje edhe ndotjen gjate transportit.

Per rritjen e efektivitetit ekonomiko-ekologjik per te gjitha veprimet konkrete do te merren masa mbikqyrese nga Drejtoria e Sherbimit Pyjor si dhe Specialist te mjedisit te qarkut te Gjirokastrës si dhe ndermarrjes pyjore pyjore në bashki.

### ***Rreziku ne shendet dhe masat per zbutjen e tij***

Rreziku ne mjedis ne shfrytezimin e karrieres eshte prezent ne proceset e rrezimit te gurit gelqeror, ngarkimin dhe transportit te tij.

Drejtuesi teknik i karrieres duhet te jete Ing. Miniere i cili duhet te beje vazhdimisht instruksionin teknik te punetoreve dhe ne vecanti te drejtuesve te mjeteve motorrike.

Ne objektet minerare te shfrytezimit te gurit gelqeror me kariere, punonjesit instruktohet teorikisht dhe ne praktik jo me pak se dy jave ne vendin e tyre te punes, mbi aksidentet e mundshme dhe masat mbrojtese ne pune. Gjate instruktimit do te punohet ne mbikqyrje te instruktorit jo me pak se nje jave ne te gjitha proceset e punes.

Per mbrojtjen nga zhurmat, punonjesit e karrieres do te perdorin kufje. Gjithashtu do te perdore uniformen e punes, doreza, çizme ose kepuce te çertifikuara per aktivitet te prodhimit industrial ne kariera.

Per reagimin e menjehershem ndaj aksidenteve te mundshem humane, karriera do te kete edhe nje ambient te mbyllur ambulance ku do te mbahet kutia e ndihmes se shpejte ne rast aksidenti ose demtim shendeti te njerzve.

### **Rreziqet nga aksidentet e mundshme ne pune dhe masat per te parandaluar aksidentet dhe minimizuar pasojat.**

Kryerja e veprimtarise minerare per prodhimin e mineralit te gurit gelqeror te mermerizuar disiplinohet me projektin teknik e teknologjik te shfrytezimit te hartuar per marrjen e lejes se shfrytezimit . Ne projekt jane parashikuar masat teknike dhe organizative per parandalimin e aksidenteve te mundshme ne mjedis te veprimtarrise dhe minimizuar pasojat ne mjedis.

Jane percaktuar kerkesat e sigurimit teknik qe do te zbatohen nga drejtuesit e aktivitetit dhe nga vet punonjesit e prodhimit.

## **9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT**

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e prodhimit te gurit gelqerore te mermerizuar me kariere ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis.

Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis.

Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatet e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark.

Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne DRM-ne e qarkut Gjirokastrës sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

## **10. PLANI I MENAXHIMIT**

*- rolet dhe pergjegjesit per zbatimin e seciles mase te propozuara per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit*

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale. Mbi depozitimin e gur gelqerornuk ka mbules dherash.. Gjith prodhimi nejo i perdorshem do te trajtohet si mbetje guri jo te demshem dhe do te sistemohen ne sheshin perkates ne nivelin fundor te karrieres +400m.

Mbetjet urbane hidhen kryesisht ne vende te caktuara per kete qellim. Ato jan minimale pasi edhe nr i te punesuarve eshte i vogel Grumbullimi dhe heqja e mbetjeve dhe sistemimi i mbetjeve sterile eshte pergjegjesi e prodhuesit.

Veprimtaria e shfrytezimit te gurit gelqerore eshte veprimtari minerare. Ajo do te zbatohet me punime siperfasore, kariere. Si rezultat i kesaj veprimtarie prodhohet mineral blloqe gur gelqeror si lende e pare ne industrine e ndertimit.

Per te shfrytezuar gurin gelqeror ne kariere hapet vendburimi me elementet e saj, rruget, gjysem transhete dhe shkallet e karrieres.

Te gjitha keto punime minerare hapen neper mineralin e gurit gelqeror.

Mbetjet qe gjenerohen gjate hapjes se rrugeve, gjysem transheve, shkalleve per zbulimin dhe nxjerrjen e mineralit jane lende e pare per perdorim ne ndertim rruges te karrieres dhe ato rurale.

## KONKLUZIONE

- E rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti te thelluar te V.N.M-se eshte se ai do ti vije ne ndihme mbrojtjes se mjedisit
- Teritori i i karrieres se gurit gelqeror nuk ka ndonje status te veçante qe pengon aktivitetin minerar ne zonen minerare me Leje Shfrytëzimi Nr. 953/1.
- Me masat qe do te merren aktiviteti nuk do te kete ndikime negative ne toke dhe nuk do te ndikojne ne ujrat siperfaqesore e nentokesore.
- Hartimi dhe zbatimi i projektit te shfrytezimit nuk do te kete ndonje pasoje negative te mundeshme ne mjedisin e zones mbasi objekti eshte vendosur ne nje teren pa ndonje zhvillim te dukshem te pyjeve apo drureve frutore,mbasi mungon vegjatacioni (formacionet nuk favorizojne zhvillimin e bimeve)
- Ndikim te priteshem do te kete vetem ne ndryshimin e pjeseshem ne toke, te peisazhit te zones qe me masat qe jane parashikuar ne terren do te zbusinkete fenomen dhe do te çojne ne permiresimin e metejsheem te tij.
- Vendin e siperfaqes se zhveshur do ta zene nje siperfaqe e pyllezuar.
- Prodhimi i gurit gelqeror eshte rezultat i rritjes se kerkesave te tregut ne industrine e ndertimit.
- Aktiviteti i shfrytezimit te gurit gelqeror ne objekt do te kete impakt pozitiv mbasi do te ndihmoje ne hapjen e vendeve te reja te punes.